

## KËRKIME GJUHËSORE

---

Arjan SHUMELI

### PËRQASJE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE TË PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË FUSHËN E AGROMEKANIKËS

Problemet e terminologjisë në fushën e agromekanikës janë të ndryshme. Kjo për vetë larminë, sasinë dhe cilësinë e leksikut terminologjik, që kjo mikrofushë e bujqësisë ka zhvilluar sidomos në periudhën e pas luftës dhe në periudhën pas viteve 90-të. Terminologjisë në fushën e agromekanikës, që nënkupton *aplikimin e mekanizimit në bujqësi*, i është kushtuar një vëmendjetë konsiderueshme, ku rezultatet janë të matshme, si në lëmin e fjalorëve terminologjikë<sup>1</sup>, ashtu edhe në punimet e studimit e shumta në fushën e bujqësisë<sup>2</sup> dhe të mekanikës<sup>3</sup>. Puna e vazhduar në këtë fushë ka ndjekur shembullin e punimeve të shumta të drejtuara nga terminologë të njohur shqiptarë (A. Kostallari, J. Thomai, M. Samara, Th. Feka, A. Duro, H. Pasho, S. Pepa, E. Lafe, H. Gorani, H. Çipuri) në fusha të tjera, të cilët kanë trajtuar si probleme të terminologjisë së përgjithshme, ashtu edhe probleme të terminologjisë së fushave të veçanta. Përfundimet e nxjerra për fushat specifike bashkohen në një pikë të vetme se *leksiku terminologjik është pasuruar tej mase duke rritur peshën specifike të leksikut të përgjithshëm të gjuhës letrare shqipe*. Pësha specifike e fjalëve-terma në leksikun e shqipes së sotme është rritur shumë dhe kjo është rezultat i arritjeve në shumë fusha dhe i pasqyrimin të tij në zhvillimin e terminologjisë së degëve të ndryshme të shkencës, teknikës dhe të prodhimit<sup>4</sup> (Feka 1986: 120). Këto zhvillime janë shoqëruar me prurje të shumta në fushën e terminologjisë së agromekanikës, ndaj studimi i fjalëve dhe termave paraqitet si një detyrë sa e rëndësishme, aq edhe e vështirë, sepse terminologjia në këtë fushë e ka zanafillën në traditën e lashtë bujqësore shqiptare duke filluar me *plugun* dhe në vazhdimësinë e saj ka fituar me qindra fjalë terma, togfjalësha të ngulitur në fushë, zgjerime të kuptimeve leksikore, huazime nga gjuhë të tjera, apo huazime brenda leksikut të shqipes, të cilat janë pasuruar nga kuptimi dhe larmia e tyre duke kontribuar në pasurinë leksikore të shqipes.

Mjafton të ndalemi tek *Fjalori terminologjik katër gjuhësh i bujqësisë* i N. Qafzezit (1978), për të kuptuar numrin e madh të fjalëve terma në këtë fjalor. Vetëm nën fjalën “*plug*” numërohen rreth 70 togfjalësha terminologjike (*plug me veshë-plug rotativ-plug automatik-plug bilancier-plug gërmues-plug gjysmë i*

---

<sup>1</sup> *Fjalori katërgjuhësh i bujqësisë* (N. Qafzezi, 1978); *Fjalori i Termave të Bujqësisë* (Tiranë, 2006). *Fjalor i terminologjisë së mekanikës* (Tiranë, 1963); *Fjalor i termave themelore të mekanikës* (Tiranë, 2002).


<sup>2</sup> S. Pepa, *Tradita Bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*, Vëllimi 1 & 2, Tiranë, 2002.

<sup>3</sup> V. Dervishi, *Terminologjia e mekanikës në gjuhën shqipe* (monografi, 1989).

<sup>4</sup> Th. Feka *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në “Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe”* (1980). Studime Filologjike. Tiranë, Nr. 2.

varur etj), rreth 36 togfjalësha terminologjike nën fjalën “lesë” (*lesa coptuese-lesa me kunjë-lesa prej druri-lesa rrotulluese dhe vibruese etj*); rreth 17 togfjalësha terminologjike nën fjalën ‘kultivatorë’ (*kultivator për rreshta te gjera-kultivator fushe-kultivator harrës-kultivator i përgjithshëm-kultivator i varur-kultivator kositës etj*). Ky numër fjalësh i leksikut terminologjik në fushën e agromekanikës paraqitet i bollshëm edhe në fjalorët shpjegues të shqipes. Më konkretisht, në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) përfshihen nën shkronjën A rreth 25 terma të fushës së agromekanikës, nën shkronjën B rreth 40 terma etj. Problemi i kësaj terminologjie mund të trajtohet në forma të ndryshme. Por, nisur nga sasia dhe larmia e termave fjalë dhe termave togfjalësh, punimi do të ndalet në rrugët e formimit të terminologjisë së fushës së agromekanikës dhe më konkretisht në *rrugën semantike*. Kjo rrugë përbën dukurinë mbizotëruese në term-formimin e shqipes, ndërsa termat togfjalësh grupin më të madh të termave në gjuhën shqipe standarde<sup>5</sup>. Pra, rruga semantike mund të pranohet më tepër si formim i një termi mbi bazën e rikuptimit të fjalës së zakonshme, ose edhe të rikonceptimit të një termi të një fushe në fushën përkatëse, që ka përmbajtje konceptore të ndryshme ose të përafërt me të parin, por që ngrihet në bazën e tij<sup>6</sup>. Duke qenë se terminologjia në fushën e agromekanikës ka karakter sistemor dhe hierarkik, do të ishte me vend të ndaleshim në paraqitjen sistimore dhe hierarkike të kësaj terminologjie. Si përfaqësuese të terminologjisë së agromekanikës, për hir të studimit në fjalë, do përzgjidhnim termin ‘*vegla bujqësore*’, i cili përfaqëson të gjitha aparatet, almiset dhe makineritë që përdoren në fushën e bujqësisë.

**Figura. 1. Paraqitje sistimore dhe hierarkike të termit “vegël bujqësore”**



Sipas paraqitjes sistimore më lart (1) *veglat e krahut për punim toke* përfshijnë termat shat (*ang. hoe*) -kazmë (*ang. pick*) -grabujë (*ang. rake*); (2) *veglat e krahut për prerje* përfshijnë drapër (*ang. sickle*) - kosë (*ang. scythe*) - gërshërë krasitjeje (*ang. pruning shears*); (3) *vegla këmbë për punim* përfshijnë termat bel (*ang. garden trowel*) - lopatë (*ang. shovel*); (4) *veglat e tërhequra me*

<sup>5</sup>V. Memisha, *Terma-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes*, në Gjendja dhe Zhvillimi Terminologjisë shqipe: probleme dhe detyra, Konferencë Shkencore, Tiranë, 2009, f. 107.

<sup>6</sup> S. Pllana, *Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përfaqje me gjuhën angleze*. Punim disertacioni.

PËRQASJE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE TË PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT  
DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË FUSHËN E AGROMEKANIKËS

*traktor* përfshijnë termat *plug* me rrota (*ang. wheel plough*) -*plug* i varur- (*ang. mounted plough*)-*plug* gjysëm i varur (*ang. semi-mounted plough*) -*disk* i dhëmbëzuar (*ang. serrated edge disc*); shpërndarëse e farës së tërfilit (*ang. clover broadcaster*). (5) *vegla bujqësore të mekanizuara të thjeshta*: makinë kositëse (*ang. motor lawn mower*) -makinë mbjellëse (*ang. seeder- (sy) seeding machine*) (6) *vegla bujqësore të mekanizuara të përbëra* përfshijnë togfjalëshat e zgjeruar autokombajnë elektrike (*ang. electric combine harvester*)- elevator me zinxhir dhe rrip (*ang. chain and slat elevator*). etj.

Para se të shtjellojmë procesin e *terminologjizimit* dhe të *shterminologjizimit* në fushën e agromekanikës do të ishte me vend trajtimi i disa koncepteve bazë, të cilat do të jenë objekt i studimit në fjalë. Zakonisht, tërësia e fjalëve që përbëjnë leksikun e gjuhës shqipe ndahet në *fjalë të zakonshme* dhe *fjalë terma*. Për Kostallar (1989:56) ndarja midis *termit* dhe *jo-termit* ekziston si e tillë vetëm përse i takon natyrës dhe karakteristikave të leksikut terminologjik dhe atij jo-terminologjik, sepse kjo ndarje zbehet dhe nuk merr rëndësi kur ne e hedhim shikimin tonë tek ‘*ndarja*’ midis dy proceseve të *terminologjizimit* dhe *shterminologjizimit*, të cilat nuk duhen parë si procese të ndërlidhura mes tyre. Kjo ndarje nuk ka kufi të prerë, sepse njësitë leksikore kalojnë anasjelltas nga njëra ndarje në tjetrën: pra njësi të leksikut popullor ngrihen në term, pra *terminologjizohen* dhe njësi të leksikut terminologjik kalojnë në fjalë të zakonshme, pra *shterminologjizohen*. Proceset e terminologjizimit të leksikut të shqipes dhe të shterminologjizimit (*në kuptimin e shtrirjes së termit në leksikun e përgjithshëm, duke ruajtur edhe më tej, doemos, vlerat e termit në fushën përkatëse*) zhvillohen në shkallë të gjerë (Feka, 1986: 121). Shqyrtimi i përbërjes së leksikut terminologjik në fushën e agromekanikës në marrëdhënie me leksikun e përgjithshëm na mundëson që të zbulojmë pikat lidhëse dhe veçoritë dalluese të këtyre dy pjesëve kryesore të leksikut: *leksikut të përgjithshëm dhe atij terminologjik*. Si hallkë ndërlidhëse ndërmjet këtyre dy tipave të leksikut shërbejnë ato njësi gjuhësore, të cilat, sipas funksionit që kryejnë, i përkasin si njëres, ashtu dhe tjetres (Duro, 2001: 21).

**PROCESI I TERMINOLOGJIZIMIT NË KRIJIMIN E TERMAVE  
TË RINJ**

Për të kuptuar më mirë kalimet dhe transferimet kuptimore të fjalëve, nga leksiku i zakonshëm në një leksik më të ngushtë të shkencës dhe të teknikës, apo nga një fushë e dijes në tjetrën, do të ishte me interes analiza skematike e fjalës *bisht* si më poshtë vijon:

**Bisht 1.** (fjalë) që shënon ose shpreh një koncept të zakonshëm.

**Bisht 1.1.** (term) që shënon një koncept shkencor teknik të ngritur mbi një koncept të zakonshëm (= *fjalë të zakonshme*). P.sh., *bisht qeni-bisht miu-bisht peshku*.

**Bisht 2** (*lopate*) term që shënon një koncept shkencor-teknik, që ngrihet nga një fjalë e zakonshme, por që kalon nga një fushë e dijes në tjetrën.

**Bisht 3.** (*dardhë*) term që shënon një koncept shkencor-teknik.

**Bisht 4.** (*kometë*) term që shënon një koncept shkencor-teknik.

**Bisht** (*nomenklaturë*). Bisht i Pallës.

Nga analiza e skemës së mësipërme mund të pohojmë që *bisht 1* dhe *bisht 1.1* shprehin koncepte të dyjëzuara, pra përmbajtje konceptore të njëjtë dhe këndvështrim të ndryshëm: (1) këndvështrim të zakonshëm (2) këndvështrim terminologjik.

Gjithashtu, fjala *bisht* hyn në lidhje me elementë të ndryshëm duke formuar togfjalësha terminologjike të ndryshëm si p.sh:



Përsa më lart, lidhja midis leksikut të përgjithshëm dhe atij terminologjik shihet tek ngritja që bëjnë fjalët e leksikut të përgjithshëm në përmbajtjen e tyre kuptimore nëpërmjet specializimit dhe përdorimit në një degë të veçantë të *shkencës, të teknikës dhe të prodhimit* (Feka, 1986: 123). Si shembull marrim fjalët *disk, krah, dhëmb*. Kështu fjala ‘*disk*’ ka në strukturën e vet 7 kuptime, nga të cilat 2 kuptime kanë karakter special terminologjik: DIS/K, ~KU *m. sh.* ~QE, ~QET. 1. *sport*. Pllakë e rrumbullakët prej druri, e mbështjellë përqark me një rreth metali, e cila flaket larg nga atletët. *Hedhja e diskut. Flak diskut.* 3. *tek*. Pjesë e një aparati, e një makine a e një mekanizmi, e cila ka trajtën e një pjate, të një sferë të shtypur nga të dyja anët ose të një rrethi; çdo gjë që ka një trajtë të tillë. *Disqe të dhëmbëzuara. Disqet e traktorit.*

Fjala *krah* ka në strukturën e saj kuptimore 17 kuptime, nga të cilat 3 kuptime kanë karakter special terminologjik: KRAH: 12. *usht*. Ana e djathtë ose e majtë e formacionit të luftimit ose të marshimit të trupave; shpinë. *Krahu i djathtë (i majtë) i ushtrisë (i frontit)*. 13. *sport*. Lojtari anësor në vijën e sulmit të një skuadre; ana e djathtë ose e majtë e vijës së sulmit (në disa lojëra me top dhe në shah). *Krahët e skuadrës së futbollit*. 14. *tek*. Pjesa e dalë dhe e lëvizshme e një mekanizmi, e një vinçi, e një ekskavatori etj. *Krahu i vinçit (i ekskavatorit). Krahu i sharrës*.

Fjala ‘*dhëmb*’ ka në strukturën e saj kuptimore 2 kuptime, nga të cilat 1 kuptim ka karakter special terminologjik: DHËMB/I = *sh.* ~Ë, ~ËT. 2. *sh.* Varg pjesësh të dala, zakonisht të mprehta ose me majë, në një vegël, në një mekanizëm a në një send tjetër; dhëmbëz; fije e hollë kallami, teli a metali e krehrit të tezgjahut.

PËRQASJE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE TË PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT  
DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË FUSHËN E AGROMEKANIKËS

*Dhëmbë të hekurt (të çeliktë). Dhëmbët e sharrës (e frezës, e ingranazhit). Dhëmbët e krehrit. Rrotë (lesë, frezë) me dhëmbë.*

Fjala *dhëmb* në gjuhë angleze ‘tooth’ ka 5 kuptime, nga të cilat, 2 kuptime kanë karakter special terminologjik: TOOTH: 1. (*Vertebrorët*) Secila nga eshtrat e ngulitura në të dyja nofullat. 2. (*Makineri*) Pjesë të dala në një ingranazh apo mekanizëm e cila kur kapet me një tjetër vë në lëvizje një mekanizëm tjetër. Veçori e fjalës ‘tooth’ (*shqip. dhëmb*) është se duke u futur në sistemin terminologjik, duke krijuar togfjalëshat terminologjikë, ajo mban lidhje me fjalën e zakonshme, e cila i takon fondit aktiv të gjuhës, duke lejuar lidhje mes elementëve të ndryshëm. Kështu, ajo hyn në përbërje të togfjalëshave të mëposhtëm: *tooth of a comb (shqip. dhëmb i krehrit) - tooth of a rake (shqip. dhëmb i grabujës) -tooth of a saw (shqip. dhëmb i sharrës), tooth of a gear (shqip. dhëmb i një ingranazhi)-tooth of a worm (shqip. dhëmbi i një vide)*. Zhvillimet kuptimore (*konceptore*) që ka termi “*dhëmbëzuar*”, si derivat i fjalës “*dhëmb*”, bëhen të dallueshme në qoftë se krahasohen me njësitë përgjegjëse (togfjalëshat terminologjikë) “*toothed*” në gjuhën angleze.

Pra, nga analiza e skemës së mëposhtme rezulton se kemi një përputhje të plotë konceptore mes togfjalëshave të gjuhës shqipe si *rrip i dhëmbëzuar* –(*ang. toothed belt*)-*sharrë e dhëmbëzuar (ang. toothed saw) –rrotë e dhëmbëzuar (ang. toothed wheel) -lesë e dhëmbëzuar (ang. toothed harrow); presë e dhëmbëzuar (ang. toothed blade)*. Por, për shenjën “*dhëmbëzuar*” në anglisht ekzistojnë edhe tri shenja të tjera që janë ‘*spike*’, ‘*tine*’, ‘*serrated*’, të cilat dalin në togfjalëshat e tipit si, *tine harrow (shqip. lesë e dhëmbëzuar), spike harrow (shqip. lesë e dhëmbëzuar), serrated edge disk (shqip. disk me buzë të dhëmbëzuar)*.

**Figura 2.** Skema e paraqitjes semantike të fjalës ‘*dhëmbëzuar*’ në togfjalëshat e gjuhës shqipe dhe angleze

Rrip i dhëmbëzuar	Sharrë edhëmbëzuar	Rrotë e dhëmbëzuar
		
Toothed belt	Toothed saw	Toothed wheel
Lesë e dhëmbëzuar	Presë e dhëmbëzuar	
		
Toothed harrow	Toothed blade	

Pra, mund të arrihet në përfundimin se në të dyja gjuhët veçori kryesore e këtyre njësive është se këto fjalë të zakonshme, edhe pse futen në sistemin

## ARJAN SHUMELI

terminologjik në fusha të veçanta të shkencës dhe teknikës, ato prapëseprapë mbajnë lidhje me kuptimin e fjalës së zakonshme. Pra, në leksikon jo-terminologjik këto fjalë janë aktive dhe hyjnë në dhjetëra kombinime të lira, ndërsa në leksikon terminologjik ato formojnë bazën e kësaj terminologjie, duke hyrë në kombinime edhe në terminologji të fushave të tjera.

*Terminologjizimi* përfshin ngritjen e fjalëve me burim nga anatomia e njeriut si *këmbë, qafë, hundë, buzë, dhëmbë, shtrat, vesh, krah* duke u kthyer në terma të specializuar me përdorim në terminologjinë e agromekanikës si, p.sh., *këmba e parmendës, qafa e zgjedhës, hunda e plorit, buza e thikës, dhëmbët e sharrës, shtrati i qerres, veshi i plugut, krahu i autokombajnës*. Për emërtimin e nocioneve të reja në fushën e agromekanikës përdoren dendur edhe fjalë të zakonshme që qëndrojnë për *kafshë, shpezë* etj, si dhe për pjesë a gjymtyrë të tyre. Më konkretisht, janë ngritur në term fjalë si, *lejlek, dallëndyshe, urith*, si edhe gjymtyrët, apo pjesët e tyre si *bisht, capua, thundër, feçkë, thumb*, etj. Më konkretisht flasim për togfjalëshat terminologjikë si *drapër lejlek, plug urith, dallëndyshja e plugut, bishti i lopatës, çaponjtë e çengelit, feçka e frezës, thumbi i hostenit*, etj. *Terminologjizimi* përfshin edhe ngritjen në term të fjalëve për pjesët e kuzhinës si *pirun, sahanë, lugë, hinkë, kapak*, të cilat përdoren në togfjalëshat të tipit *pirun për pleh, sahanë të dhëmbëzuar, plug me lug, hinka e farës, hinka e shumëzimit, hinka ndarëse, tehu i thikës, kapaku i arkës së farës* etj.

Si fjalë të zakonshme që ngrihen në terma përdoren fjalë që shënojnë edhe pjesë të *ndërtesës* si *dysheme, shtrat, kullë, kanat, derë, dhomë*, kjo, për faktin se pjesët e makinerive bujqësore si, p.sh., *autokombajna, makinat shirëse* etj, kanë ngjashmëri në *formë, planimetri, funksion, pozicion* dhe *vendosje* me pjesë të veçanta të ndërtesave. Fjalët e mësipërme janë ngritur në terma duke gjetur përdorim në togfjalëshat e tipit, *dyshemeja e qerres, shtrati i qerres, kanatet e qerres, kulla e shpimit, dhoma e ftohjes, dhoma e ngrohjes, dhoma e farë, dhomë pluskuese* etj.

### PROCESI I SHTERMINOLOGJIZIMIT NË PASURIMIN E LEKSIKUT TË SHQIPES

Lidhur me procesin e *shterminologjizimit* B. I. Karsh<sup>7</sup> dallon dy kategori të *shterminologjizimit*: 1) rasti i parë kur termi ruan në thelb të njëjtin kuptim, por nuk përdoret më nga ekspertët të fushës që i referohet një koncepti në atë fushë. Në këtë rast lënda e subjektit mund të jetë popullarizuar dhe jospecialisti arrin të kuptojë mjaft gjëra për konceptin në përdorimin e termit. Termi sipas përdorimit të jospecialistit i referohet një kuptim ‘më të cekët’ të konceptit ose konceptit kur ai ka konotacione të tjera. Në këtë rast B. I. Karch sjell shembuj sëmundjesh nga fusha e mjekësisë që janë të pranishme dhe të kuptueshme për të gjithë njerëzit. Pagjumësia njihet në anglisht me termin “*insomnia*”, e cila mund të jetë kronike, e ndërprerë ose edhe vdekjeprurëse. Por në raste të tjera mund të flasim për përdorimin e termit “*insomnia*” në një kuptim më pak mjekësor duke e përdorur

<sup>7</sup> “A home run is a home run is a home run?” At <http://bikterminology.com/tag/determinologization/>.

PËRQASJE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE TË PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT  
DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË FUSHËN E AGROMEKANIKËS

termin me kuptimin “*mungesë gjumi -lack of sleep*” pra, “*pagjumësia (insomnia) e detyroi të largohej nga hoteli dhe të kthente disa gota birra në lokal*”. 2) rasti i dytë ndodh kur fjala përshkruan një koncept krejt të ndryshëm. Ndërsa fjala ndan disa karakteristika me kuptimin e termit në fushën teknike, ai nuk ndan më karakteristikat thelbësore me të. Si shembuj sillet termi “*home run*” nga fusha e bejsbollit, i cili kur përdoret si “*to hit a home run*” merr kuptimin e të *pasurit sukses në diçka*.

Brenda leksikut terminologjik veçohet ajo pjesë e leksikut (terma), e cila ka përdorim të gjerë nga pjesa tjetër që përdoret vetëm në një rreth të ngushtë të specialistëve të një dege të shkencës, teknikës a të prodhimit. Në këtë këndvështrim, këto terma që shprehin nocione të përgjithshme (*aparate, arkë, bisht, bllok*) afrohen më shpejt me leksikun e përgjithshëm e të zakonshëm të gjuhës, prandaj përfshihen në fjalësin e fjalorit shpjegues e me karakter të shqipes<sup>8</sup>. Pra në këtë kuptim, termat shpeshputen nga kuptimi i tyre i ngurtë brenda një fushë të caktuar, ku kuptohen dhe përdoren në kuptimin e tyre të specializuar nga specialistë të fushës së dhënë duke fituar një kuptim të gjithanshëm nga një masë e gjerë njerëzish. Sipas Th. Fekës (1980) afrimi i një fjale të leksikut terminologjik tekniko-shkencor në leksikun e përgjithshëm të gjuhës së sotme letrare përcaktohet nga shkalla e njohjes së sendeve e të dukurive dhe nga shkalla e përdorimit të termave nga një masë e gjerë njerëzish. Përveç kuptimit terminologjik të disa termave fitohen dhe zhvillohen edhe kuptime të reja që nuk kanë kuptim terminologjik. Në këtë rast, përmbajtja kuptimore e këtyre fjalëve-terma pasurohet me kuptime të tjera që kanë kuptim të përgjithshëm. Pra në këtë rast kemi zgjerim të kuptimit të fjalës, kalim të kësaj fjale në leksikun e përgjithshëm, pra *shterminologjizim të termit*.

Si shembull këtu mund të marrim termat *motor, vegël, gërshërë*. Kështu termi *motor*, përveç kuptimit terminologjik “*makinë e posaçme që punon me lëndë djegëse, me energji elektrike etj. dhe vë në lëvizje makina të tjera, aparate e mjete të ndryshme*”, ka fituar edhe një kuptim tjetër të përgjithshëm, që nuk ka kuptim terminologjik në fjalitë e mëposhtme “*investimet e huaja si motor zhvillimi lokal*”- “*fëmija tani është një motor plot energji*” - “*motor kërkimi në internet*” - “*ai punon si motor*”.

Termi *vegël*, përveç kuptimit terminologjik “*mjet i thjeshtë a përdorëse që shërben për të bërë një punë ose për të kryer një veprim*”, ka fituar edhe kuptim tjetër “*Njeri që vihet në shërbim të dikujt dhe bën punën e tij, njeri a grup njerëzish, që i shërbejnë dikujt si mashë për të arritur qëllime të caktuara*”, siç ilustron në shembujt “*vegël politike*” “*është bërë vegla e tjetrit*” etj.

Termi *gërshërë*, veç kuptimit terminologjik “*makinë a mekanizëm me dy krahë të mprehtë për prerjen e metaleve të ndryshme, të lëkurës etj*”, përdoret edhe në kuptimin e përgjithshëm *shkurtoj* si p.sh në fjalitë “*gërshërët dhe shiritat*

<sup>8</sup> Th. Feka, “Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në Fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe” tek Leksiku III). 1989: 585.

*elektoralë mund të rezultojnë armët vrasëse dhe mbytëse të ekonomisë kombëtare*”-“*Shkurtime në pediatri, 'gërshërë' stafit dhe shtretërve*”. Në këtë rast, përmbajtja kuptimore e këtyre fjalëve-terma pasurohet me kuptime të tjera që kanë kuptim të përgjithshëm. Ky është tregues i zgjerimit të përdorimit të leksikut terminologjik dhe i afrimit të tij me leksikun e përgjithshëm.

Është më interes të vihet në dukje se kuptimet terminologjike të fjalëve janë në pjesën më të madhe zgjerime kuptimore dhe midis tyre ka dhe shumë kuptime të figurshme. Tipike për këta togfjalësha është aftësia e tyre për t'u bazuar në termin apo fjalën terminologjike, përfshirë termin në fushën e agromekanikës, duke rifituar një kuptimësi të re që e afron atë drejt kuptimit të figurshëm. Këto togfjalësha në këtë mënyrë bëhen pronë, jo vetëm e ligjërimit bisedor, letrar, por edhe e gjuhës së letërsisë artistike, publicistike. Këtu mund të citojmë një listë termash të cilët janë shndërruar në kuptimin e tyre të figurshëm-vlerësues të fjalëve si: - *i vuri \*kazmën (prish), e ka gojën \*lopatë (flet shumë); fiton me lopatë (fiton shumë); nuk i merr ujë lopata; i ka prerë një \*sharrë (janë njësoj).*

#### **RI-TERMINOLOGJIZIMI SI PROCES NË KRIJIMIN E TERMAVE TË RINJ**

Shpesh është e nevojshme që kuptimin e modifikuar të një termi t'ia atribuojmë një termi tjetër në përdorim në një fushë tjetër, me kusht që fusha nga ku është huazuar termi të jetë e pozicionuar sa më larg fushës në fjalë për të shmangur çdo paqartësi në kuptim. Një term i tillë quhet *term i transferuar*<sup>9</sup>. Nga fusha e mjekësisë është huazuar në fushën e agromekanikës duke u *ri-terminologjizuar* termi *tub ushqyes* në kombinimin e tipit *tub ushqyes* tek *makinat dezinfektuese të drithit*; Nga sistemi bankar është *ri-terminologjizuar* fjala *depozitë* në kombinimin e tipit *depozita e pluhurit* tek *makinat dezinfektuese të drithit*; apo *arka e drithit* tek *autokombajna*; *depozita e benzinës* tek *blloku i cilindrave* etj. Nga fusha e mekanikës së përgjithshme është huazuar fjala *elevator* si *pjesë e makinës së dezinfektimit të drithit*; bashkë me fjalën *transportier* i *drithit* tek *makina dezinfektuese e drithit*; *filtr*; *levat e ngritjes dhe uljes së brazdareve*. Nga fusha e ndërtimit është huazuar termi *traversë*; tek *makinat mbjellëse*, apo fjala *bllok* në kombinimet e tipit *blloku i motorit*, *blloku i cilindrave*, apo edhe *nivelues i muratorit* tek *nivelues* në kuptimin *mekanizëm me levë ose me vidhë që shërben për nivelimin e plugut në drejtimin tërthor a për të siguruar gjerësinë normale të punës*. Nga fusha e gjeometrisë janë huazuar termat '*paralelogrami mbështetës* tek *makinat mbjellëse me saktësi*; *trapezi i plorit*; *kubik formues me dorë*; *seksion paralelogram*, *lesa me kunjë prizmatikë*, *lesë trekëndëshe*, *disk rruzullor*; *mbjellëse me fole katrore*; *sharrë rrethore*; *shihedhës rrethor*. Nga fusha e ushtrisë është huazuar fjala *fole* në kombinimin e *folesë si pjesë e aparatit shpërndarës*; *gjurmëlënës si pjesë e makinave mbjellëse me rreshta*, *armaturë e traktorëve*; *foleja e valvulës*; *shtytësi i motorit* etj. Nga fusha e sportit është huazuar termi *notues* në kombinimin e *notues si pjesë e bllokut të cilindrave*. Nga

<sup>9</sup> H. Fleber, "Basic principles and methods for the preparation of terminology standards" tek "Standardization of Technical Terminology: principles and practices". Heyman, 1983.

PËRQASJE NË SHQIPE DHE ANGLISHTE TË PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT  
DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË FUSHËN E AGROMEKANIKËS

---

fusha e meteorologjisë janë huazuar fjalët *rryma* në kombinimin *rryma e ajrit* tek *makina mbjellëse me shpërndarje qendrore*, apo fjala *ciklon* në një lloj makine e quajtur *ciklon*, e cila për shkak të formës dhe forcës natyrore që gjeneron, është ngritur në term me kuptimin *aparati që depoziton pluhura ose substanca të tjera, i cili përdoret në mullinjtë e blojës, për grumbullimin e miellit që ngrihet në ajër gjatë bluarjes*.

#### BIBLIOGRAFI

1980. *Fjalori i Shqipes së Sotme*.
2001. *Oxford Advanced Learner's Dictionary*.
- A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, Penteon, 2001.
- A. Kostallari, *Çështje të leksikologjisë. Gjuha Letrare Kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. III. Tiranë, 1989.
- Dictionary dot.com. <http://dictionary.reference.com/browse/teeth?> 2012
- H. Fleber, "Basic principles and methods for the preparation of terminology standards" tek "Standardization of Technical Terminology: principles and practices". Heyman, 1983.
- N. Qafzezi, *Fjalori i Bujqësisë*. Tiranë, 1978.
- S. Pepa, *Tradita Bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*, Vëllimi 1 & 2, Tiranë, 2002.
- S. Pllana, *Leksiku terminologjik bazë i mekanikës në gjuhën shqipe në përjasje me gjuhën angleze*. Punim disertacioni. Tiranë, 2009.
- Th, Feka, *Vëshgime të Vëshgime mbi leksikon terminologjik në "Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe"*, 1980, Studime Filologjike. Tiranë, Nr. 2
- V. Dervishi, *Terminologjia e mekanikës në gjuhën shqipe* (monografi, 1989).
- V. Memisha, *Termt-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes*. Gjendja dhe Zhvillimi Terminologjisë shqipe: Probleme dhe detyra. Konferencë shkencore, Tiranë, 2009.